



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1318/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Fatbardha Emimi, në cilësinë e Kandidates për Anëtare të Kuvendit Komunal në Viti, nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), paraqitur kundër shpalljes së rezultateve përfundimtare nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), për Zgjedhjet Lokale në seancën e panelit të mbajtur me 27.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Fatbardha Emimi, në cilësinë e Kandidates për Anëtare të Kuvendit Komunal në Viti, nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK).

Arsyetim

PZAP-i, me datë 24.12.2013 ka pranuar një ankesë nga Fatbardha Emimi, në cilësinë e Kandidates për Anëtare të Kuvendit Komunal në Viti, nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), me të cilën pretendon se në Vendvotimet 2606D/01R/02D, 2605D/02R/04R, 2625D/01D, 2620D/01R/02D, 2601D/04R, 2601X/02R dhe 2617D/02R/03D, ka pasur prishje të fletëvotimeve. Sipas parashtruesit të ankesës kjo dëshmohej edhe me publikimin e rezultateve në ueb-faqen e KQZ-së, se në komunën e Vitisë gjenden 1,632 fletëvotime të pavlefshme po ashtu kishte numërim jo të drejtë sa i përket votave të kandidatëve.

Me propozim që të rinumërohen Vendvotimet e sipërsënuara dhe të bëhet i verifikimi i fletëvotimeve ngjyra e stilolapsit që është përdorë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi ankesën gjeti se:

ankesa është e pabazuar

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore të Fatbardha Emimi, në cilësinë e Kandidates për Anëtare të Kuvendit Komunal në Viti, nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) nuk qëndrojnë ngase nuk ka ofruar asnjë dëshmi për atë që pretendon në ankesë ndaj pretendimet e tilla janë të pa argumentuara në fakte dhe dëshmi konkrete prandaj ankesa vlerësohet si e pa bazë, duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 1318/2013 më datën 27.12.2013.



Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha

Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.